

V E N D I M
Nr.55, datë 30.1.1995

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.465, DATË 3.10.1994 “PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.47, DATË 7.2.1994 “PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHTETËRORE QË PRIVATIZOHET OSE VENDOSËT NË SHOQËRITË E PËRBASHKËTA, SI DHE PËRCAKTIMI I QIRASË PËR OBJEKTET SHTETËRORE QË U JEPEN NË PËRDORIM TË TRETËVE””

ME PROPOZIMIN E MINISTRISË SË FINANCAVE, KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D O S I:

1. Në pikën 4 shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:
“Likuidimi i detyrimeve të fondit kundërparti për ndihmat shtetërore ushqimore e industriale të ndërmarrjeve që privatizohen, të bëhen vetëm në lekë.
Për rastet e privatizimeve të kryera para daljes së këtij vendimi, likuidimi mund të jetë edhe me letra me vlerë privatizimi. Evidencimi i fondit kundërparti nëpërmjet letrave me vlerë të bëhet nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit”.
2. Ngarkohet Ministria e Financave të nxjerrë udhëzim për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi